

KUSHTET E PËRGJITHËSHME TË SIGURIMIT TË MALLRAVE GJATË TRANSPORTIT

Rreziqet e mbuluara:

Mbulimi A

1.A Ky sigurim mbulon të gjitha risqet për humbjet ose dëmtimet e subjektit të siguruar përveç sa parashikohet nga klauzolat 7,8,9 dhe 10 më poshtë.

Mbulimi B

1. B Ky sigurim mbulon, përveç sa është parashikuar në klauzolat 7,8,9 dhe 10 më poshtë:

1.1.B Humbjen ose dëmtimin e objektit të këtij sigurimi për shkak të:

1.1.1. zjarrit ose shpërthimit;

1.1.2. mjetit lundrues të ngecur në rrëre ose të mbytur në det;

1.1.3. kthimit ose përmbysjes së mjetit të transportit tokësor;

1.1.4. përplasjes ose kontaktit me ndonjë mjet tjetër lundrues ose mjet tokësor me çdo object tjetër të jashtëm përveç se ujë;

1.1.5. shkarkimit të mallit në një port ndihme;

1.1.6. shpërthimit vullkanik ose prej tërmetit dhe rrufeja;

1.2.B Humbja ose dëmtimi i objektit të siguruar shkaktuar nga:

1.2.1. sakrifikimi i një pjese të ngarkesës që çon në shpëtimin e mjetit;

1.2.2. hedhja e ngarkesës nga mjeti lundrues;

1.2.3. futja e ujit të liqenit, detit ose lumit në mjetin lundrues, mjetin tokësor ose në vendin e ruajtjes.

1.3.B Humbja totale e ndonjë pakete që ka humbur në bord ose ka rënë ndërkohë që po ngarkohej apo po shkarkohej nga mjeti.

Mbulimi C

1.C Ky sigurim mbulon, përveç sa është parashikuar në klauzolat 7,8,9 dhe 10 më poshtë:

1.1.C humbjen ose dëmtimin e objektit të këtij sigurimi për shkak të:

1.1.1. zjarrit ose shpërthimit;

1.1.2. mjetit lundrues të ngecur në rrëre ose është mbytur në det;

1.1.3. kthimit ose përmbysjes së mjetit të transportit tokësor;

1.1.4. përplasjes ose kontaktit me ndonjë mjet tjetër lundrues ose mjet tokësor me çdo object tjetër të jashtëm përveç se ujë;

1.1.5. shkarkimit të mallit në një port ndihme.

1.2.C Humbjen ose dëmtimin e objektit të siguruar shkaktuar nga:

1.2.1. sakrifikimi i një pjese të ngarkesës që çon në shpëtimin e mjetit;

1.2.2. hedhja e ngarkesës nga mjeti lundrues.

Klauzola e mesatares së përgjithëshme

2. Ky sigurim mbulon shpenzimet mesatare të përgjithëshme si dhe shpenzimet për shpëtim, të axhustuara ose të përcaktuara sipas kontratës së transportit dhe/ose ligjit dhe praktikave në fuqi, që kryhen për të shmangur ose që kanë lidhje me shmangien e humbjes nga çdo shkak me përjashtim të atyre të specifikuara në klauzolat 7,8,9 dhe 10 apo në çdo vend tjetër në këtë kontratë.

Faji i përplasjes i të dyja palëve

3. Ky sigurim shtrin efektet e saj që të dëmshpërblejë të Siguruarin kundrejt kësaj ndarje të përgjegjësisë sipas kontratës së transportit “I përplasjes me faj të të dyja palëve” (“Both to blame Collision”) kur i përket një humbje të rekuperueshme sipas këtyre kushteve. Në rast të ndonjë dëmi nga pronarët e mjetit lundrues sipas klauzolës në fjalë, I Siguruarin bie dakord që të njoftojë Siguruesin i cili ka të drejtë që me shpenzimet e tij, të mbrojë të siguruarin sipas këtij dëmi.

Pranimi i llojit të transportit

4. Kompania e sigurimeve është përgjegjëse vetëm nëse mjetet mbartëse me të cilat janë transportuar mallrat plotësojnë kërkesat e mëposhtëme:

4.1 Për transportin Detar

Anijet duhet të plotësojnë Klauzolat e Institutit të Klasifikimit të Londrës, për anijet më moshë mbi 15 vjet do të ketë një prim shtesë i cili do të varrojë në vartësi të grupeve të vjetërsisë që janë:

16-25 vjet tarfa rritet me një koeficient 0.15

26-35 vjet tarifa rritet me një koeficient 0.25

4.2 Për transportin ajror

Avionet duhet të jenë të licensuar zyrtarisht nga shoqëritë dhe autoritetet ajrore të transportit.

5. Franshiza/Pjesa e zbritëshme

Kompania e sigurimeve është përgjegjëse për të gjithë humbjen ose dëmtimin në qoftë se kjo tejkalon limitin e caktuar si franshizë ose pjesë të zbritëshme në policë.

6. Kontrata e sigurimit

6.1 Përmbajtja e kontratës

Kontrata e sigurimit lidhet në bazë të një kërkesë me shkrim nga ana e të Siguruarit, e cila duhet të përmbajë të dhënat e poshtëshënuara:

Përshkrimin e saktë të mallit, llojin e paketimit, numrin e pakove dhe peshën;

Numrat e datat e policave të ngarkesës dhe dokumentave të tjera të transportit (kontraten e transportit);

Llojin e transportit (në atë detar, emrin, vitin e ndërtimit dhe flamurin e anijes);

Vendin e ngarkimit, tranzitit dhe arritjes së mallit;

Shumën e sigurimit të mallit;

Kushtet e sigurimit të mallit.

6.2 Lidhja e kontratës

Kontrata e Sigurimit quhet e lidhur nga momenti i lëshimit të policës së sigurimit nga Kompania e Sigurimit pasi është pranuar kërkesa me shkrim nga I Siguruari.

6.3 Transferimi i Kontratës

Polica e sigurimit mund të transferohet nga i Siguruari nje personi tjetër me ane të shënimit përkatës në policën e sigurimit.

6.4 Pagimi i primit të sigurimit

I Siguruari detyrohet t'i paguajë Kompanisë së Sigurimeve primin e caktuar në policën e sigurimit. Kontrata e sigurimit nuk hyn në fuqi para pagimit të primit, në qoftë se nuk parashikohet ndryshe ne kontrate.

6.5 Detyra e njohjes se te Siguruarit

I Siguruari eshte i detyruar t'i paraqese vullnetarisht Siguruesit te gjitha rrethanat e mundeshme qe ndikojne ne vleresimin e rrezikut. Kur sigurimi eshte kontaktuar per llogari te nje pale te trete ose nga nje agjent i te siguruarit, te jepen rrethanat e njohura per te siguruarin ose agjentin.

Perjashtime

Klauzola e perjashtimeve te pergjitheshme

7. Në asnjë rast ky sigurim nuk do të mbulojë:

7.1 Humbjet ose dëmtimet për shkak të drejtimit të keq me dashje të të siguruarit.

7.2 Rrjedhjet e zakonshme, humbja e zakonshme në peshë ose volum ose grisja ose prishja e objektit të siguruar.

7.3 Humbja, dëmtimi ose shpenzimet e bëra për shkak të pamjaftueshmërisë ose papërshtatshmërisë së paketimit ose përgatitjes së objektit të siguruar (për qëllim të kësaj klauzole 4.3 termi “paketimi” përfshin depozitimin në një kontejner ose ashensor por vetëm kur ky depozitim është bërë përpara se ky sigurim të hyjë në fuqi nga Siguruesi ose punonjësit e tij)

- 7.4 Humbja, dëmtimi apo shpenzimet që shkaktohen nga natyra ose difekte të lindura të objektit të siguruar.
- 7.5 Humbja, dëmtimi ose shpenzimet e shkaktuara nga vonesa, edhe nëse kjo vonesë është shkaktuar nga një rrezik i mbuluar sipas kësaj police (përveç shpenzimeve të pagueshme sipas klauzolës 2)
- 7.6 Humbja, dëmi ose shpenzimet që rrjedhin nga falimentimet financiare të pronarëve, menaxherëve, atyre me të drejta të veçanta ose operatorëve të anijes.
- 7.7 Humbja, dëmi ose shpenzimet që lindin nga përdorimi i çdo lloj armatimi luftarak që mbështet dhe shfrytëzon reaksionet atomike dhe nukleare, shpërthimi ose reaksione të tjera të ngjashme ose nga forca dhe lëndët radioaktive.
- 7.8 Pirateria

Klauzola e përjashtimit të pavlefshëmërisë dhe papërshtatmërisë;

8.1 Kompania e Sigurimeve nuk është përgjegjëse për:

Papërshtatshmërinë e lëvizjes së anijes ose mjetit të transportit;

Papërshtatshmërinë e anijes, mjetit të transportit, konteinerit ose vinçit transportues për mbajtjen e sigurt të objektit të siguruar;

Kur i siguruari ose hallkat e tij janë në dijeni për këto papërshtatshmëri në kohën kur ngarkohet objekti i siguruar.

8.2 Siguruesi nuk merr parasysh ndonjë prishje të garancive të lëshuara për shkak të papërshkueshmërisë së detit nga anija ose papërshtatshmëria e anijes për të transportuar objektin e siguruar përveç në rastet kur I Siguruari ose punonjësit e tij, nuk janë në dijeni të këtij fakti.

Klauzola e përjashtimit të Luftës

9 Në asnjë rast Siguruesi nuk mbulon humbje, dëme ose shpenzime të shkaktuara nga:

9.1 lufta civile, lufta, revolucioni ose akte armiqësore nga ose kundër një fuqie ndërluftuese.

9.2 kapja, mbajtja, arrestimi, kufizimi ose pengimi dhe çdo pasojë ose përpjekje që lind nga kjo.

9.3 mina, silura, bomba ose armë të tjera luftarake të lëna nga lufta.

Klauzola e përjashtimit të Trazirave

10. Në asnjë rast Siguruesi nuk mbulon humbje, dëmtime ose shpenzime:

10.1 Të shkaktuara nga punëtorët që kanë ndërprerë punën ose personat që marrin pjesë në trazirat e punës, turbullirat ose trazirat civile;

10.2 Që vijnë nga grevat, ndërprerjet e punës, trazirat ose turbullirat civile;

10.2.1.1 të shkaktuara nga çdo terrorist që vepron me motive politike;

Periudha e Sigurimit

11. Klauzola e tranzitit

11.1 Ky sigurim fillon nga koha që mallrat lëvizin nga magazinat në vendin e caktuar për fillimin e transportimit, vazhdon në rrjedhën e zakonshme të transportit dhe përfundon:

11.1.1 me dorëzimin e mallit tek marrësi i ngarkesës, ose në magazinën përfundimtare ose në vendin e magazinimit në destinacionin e caktuar;

11.1.2 me dorëzimin në një magazinë tjetër që e zgjedh paraprakisht i siguruari ose në vendin e destinacionit të caktuar për tu përdorur, cilëndo të zgjedhë i Siguruari;

11.1.2.1 për ruajtje në një vend të ndryshëm nga rrjedha e zakonshme e transportit;

11.1.2.2 për shpërndarje;

Ose

11.1.3 pas përfundimit të 60 ditëve pasi bëhet shkarkimi i mallrave të siguruar nga anija në portin e fundit të shkarkimit;

cila nga këto të ndodhë e para.

11.2 Nëse pas shkarkimit nga anija në portin e fundit të shkarkimit por përpara përfundimit të këtij sigurimi, mallrat duhen dërguar në një destinacion të ndryshëm nga ai që është i përcaktuar në

policë, kjo policë nuk i shtrin efektet e saj për këtë transport nëse nuk është i shënuar në policën e sigurimit.

11.3 Ky sigurim do të mbetet në fuqi gjatë vonesave që nuk varen nga i Siguruari, për çdo devijim, shkarkim të detyruar, ringarkim ose ritransportim dhe gjatë çdo ndryshimi nga të papriturat që lindin nga e drejta që kanë anijet ose qiramarrësit sipas kontratës së transportit.

Kaluzola e përfundimit të kontratës së ngarkesës

12 Nëse lindin rrethana që janë jashtë kontrollit të të Siguarit dhe kontrata e ngarkesës përfundon në ndonjë port ose vend të ndryshëm nga ai i shënuar në policë ose transporti përfundon në ndonjë mënyrë tjetër përpara dërgimit të mallit, atëherë ky sigurim do të përfundojë përveç nëse i është dhënë njoftim i menjëhershëm Siguruesit dhe është kërkuar vazhdimi i këtij sigurimi, duke paguar primin shtesë.

12.1 Për sa kohë mallrat janë shitur dhe dorëzuar në vendin ose portin e caktuar, ose përveç nëse është specifikuar ose rënë dakord ndryshe, deri në përfundim të 60 ditëve pas arritjes së mallrave në portin ose vendin e specifikuar në policë, cilado të ndodhë e para.

Ose

12.2 Nëse mallrat janë dërguar brenda periudhës së rënë dakord në destinacionin e përcaktuar ose në çdo destinacion tjetër, derisa të përfundojë në përputhje me Nenin 8 më lart.

Klauzola e ndryshimit të destinacionit

13 Nëse pas lëshimit të policës ndryshohet destinacioni nga i Siguruari, mbulimi mbetet në fuqi duke bërë modifikime në kushte si dhe në prim.

Përcaktimi i Vlerës

14. Vlera e Sigurimit

Vlera e sigurimit i korrespondon vlerës së mallrave në kohën dhe vendin e fillimit të udhëtimit të siguruar duke i shtuar shpenzimet e transportit, sigurimin dhe shpenzime të tjera që do të kryhen deri në destinacion. Gjithashtu do të përfshihet edhe fitimi i munguar deri në 10% mbi vlefën e mallrave.

15. Vlera e Zëvendësimit

Vlera e zëvendësimit është ajo të cilën mallrat kishin patur në destinacion në kohën e ndodhjes së humbjes ose dëmit. Në mungesë të dëshmisë vlera e zëvendësimit është pranuar t'i korrespondojë vlerës së siguruar.

16. Shuma e sigurimit

Shuma e siguruar konsiston në limitin e dëmshpërblimeve për humbje ose dëme të shkaktuara nga një ose më shumë ngjarje.

17. Sigurimi i pjesshëm

Në qoftë se shuma e siguruar është më e ulët se vlera e zëvendësimit, Kompania e Sigurimeve është përgjegjëse vetëm për përpjestime të tilla të humbjes ose dëmit sa shuma e siguruar qëndron ndaj vlerës së zëvendësimit.

Dëmet

Klauzola e interesit të sigurueshëm

18.1 Në mënyrë që të mbuloheni me këtë sigurim, I Siguruari duhet të ketë një interes të sigurueshëm mbi objektin siguruar në momentin e ndodhjes së dëmit.

18.2 I Siguruari ka të drejtë të përfitojë nga ky sigurim për dëmet që ndodhin gjatë periudhës së sigurimit.

Klauzola e Shpenzimeve Shtesë

19. Kur si rezultat i veprimit të një rreziku të mbuluar udhëtimi i siguruar përfundon në një port ose vend ndryshe nga ai i specifikuar në policë, Siguruesi do të rimbursojë të Siguarin për shpenzimet ekstra të bërë në mënyrën e duhur dhe të arësyeshme që bëhen gjatë shkarkimit, magazinimit apo transportimit të objektit të siguruar në destinacionin e përcaktuar në policë.

Kjo klauzolë nuk aplikohet për **Klauzolën e mesatares së përgjithëshme**, do të jetë subjekt i përjashtimeve në klauzolat 7,8,9 dhe 10 më sipër, dhe nuk do të përfshijnë shpenzimet që lindin nga faji dhe neglizhenca e rëndë ose pamjaftueshmëria financiare e të Siguruarit dhe punonjësve të tij.

Klauzola e Humbjes Totale të Konstruksionit

20. Asnjë dëm për Humbje totale e ndodhur nuk do të paguhet nën këto kushte përveç nëse objekti i siguruar është i braktisur për një arsye të caktuar ose për shkak se humbja totale aktuale duket të jetë e pashmangshme ose sepse kostoja e rekuperimit, e kthimit ose e dërgimit të mallit të siguruar në destinacionin e shënuar në policë, e tejkalon vlerën për të cilën është siguruar.

Klauzola e rritjes së vlerës

20.1 Nëse është shkaktuar ndonjë rritje e vlerës së sigurimit nga I Siguruari për mallin që transportohet sipas kësaj police, vlera e rënë dakord do të rritet deri në shumën totale të siguruar sipas kësaj police dhe nëse një dëm ndodh gjatë periudhës së siguruar ai do të paguhet në pro rata.

Në rast të ndodhjes së dëmit I Siguruari duhet t'i japë prova Siguruesit për shumën e siguruar me kontrata të tjera sigurimi.

20.2 Kur ky sigurim është me një vlerë të rritur, atëherë klauzola e mëposhtme do të zbatohet:

Vlera e rënë dakord e mallit për tu transportuar duhet të jetë e barabartë me shumën totale të siguruar sipas sigurimit kryesor dhe të gjitha vlerat e siguruar të rritura si dhe dëmet e paguara nën këtë sigurim do të jenë në proporcion me shumën e siguruar nën këtë policë si dhe shumën që do të kërkonte ky sigurim.

Në rast dëmi I Siguruari duhet të sigurojë prova për shumën totale të siguruar nën këtë sigurim.

Përfitimet e Sigurimit

21 Ky sigurim nuk lëshohet në përfitim të transportuesit apo personave të tjerë.

Minimizimi i dëmeve

Klauzola e detyrave të të Siguruarit

22 Është detyrë e të Siguruarit dhe punonjësve të tij që për dëmin e shkaktuar:

22.1 të marrë masa të nevojshme me qëllim që të parandalojë ose të minimizojë këtë dëm, dhe

22.2 të sigurojë se të gjitha të drejtat kundrejt transportuesit ose palëve të treta janë ushtruar ashtu siç duhet dhe Siguruesi do të dëmshpërblejë për shpenzimet të bëra në mënyrë të arësyeshme në përmbushje të këtyre detyrave.

Klauzola e Heqjes Dorë

23. Masat e marra nga I Siguruari ose Siguruesi që kanë si qëllim ruajtjen, mbrojtjen ose rekuperimin e objektit të siguruar, nuk do të konsiderohet si e drejtë për të anuluar kontratën, ose pranimi i braktisjes ose përndryshe do të gjykohen të drejtat e palës tjetër.

Shmangia e Vonesës

Klauzola e diskutimeve të arësyeshme

24. Është kusht i këtij sigurimi që I Siguruari të veprojë në mënyrë të arësyeshme në të gjitha rrethanat dhe brenda kontrollit të tyre.

Detyrime në rast dëmi

25.1 Njoftimi i humbjes ose dëmit

I siguruari duhet të njoftojë Kompaninë e Sigurimeve brenda 48 orëve nga çasti që ka marrë dijeni për vërtetimin e ngjarjes së sigurimit dhe të marrë pa vonesë të gjitha masat për ruajtjen ose shpëtimin e mallrave dhe për minimizimin e humbjes ose dëmit.

25.2 Ruajtja e të drejtave për regres

I siguruari është i detyruar të ruaj të gjitha të drejtat për regres kundrejt personave të tretë të cilët mund të jenë përgjegjës për dëmin ose humbjen dhe përgjigjen për çdo veprim që çënon të drejtën e regresit. Në veçanti i siguruari duhet të marrë këto masa:

25.2 Dëmet e dukshme i njoftohen me shkrim transportuesit përpara marrjes në dorëzim të mallrave;

25.3

Kur mendohet se ka dëme të bëhen reklamime të nevojshme brenda afateve ligjore ose të parashikuara me kontratë;

Kur ka mosmarrëveshje për përcaktimin e madhësisë së dëmit, për vërtetimin e tij thirret edhe transportuesi.

Vlerësimi i humbjes ose dëmit dhe deklarimet

26.1 Vlerësimi i ekspertit

Në qoftë se palët nuk mund të bien dakort përse i përket shkakut, natyrës dhe shtrirjes së humbjes ose dëmit, do të thirret një ekspert. Raporti i ekspertit do të përmbajë të gjitha informacionet e nevojshme për të përcaktuar shtrirjen e përgjegjësisë së siguruesit dhe për të vlerësuar shumën e humbjes ose dëmit.

26.2 Reklamimet

Reklamuesi duhet të justifikojë të drejtën e tij të reklamoj me anë të policës ose çertifikatës së sigurimit. Ai duhet për më tepër të provojë që në drejtim të udhëtimit të siguruar, mallrat pësojnë humbje ose dëm për të cilën Kompania e Sigurimeve përgjigjet. Gjithashtu ai paraqet deklaratën e reklamimit së bashku me të gjitha dokumentat e nevojshme si:

Policën e sigurimit origjinal;

Faturat origjinale të mallit;

Fletë ngarkesa origjinale e mallit;

Raporti i vëzhgimit origjinal;

Raporti i ekspertit;

Çertifikatën Origjinale;

Procesverbalet për transportin;

Llogaritja e madhësisë së dëmit;

Procesverbalin e rilverësimit kur bëhet rivlerësimi i mallrave të dëmtuara që mund të përdoren;

Dokumenta të tjera që mund të kërkohen nga siguruesi.

Ligji dhe praktika

27.1 Afati i pagesës

I siguruari ka të drejtë të kërkojë nga Kompania e Sigurimit pagesën e dëmshpërblimit brenda 24 muajve nga data e lindjes së kësaj të drejte.

27.2 Detyrimi i të drejtës për regres

I siguruari i jep kompanisë së Sigurimit të gjitha të drejtat kundrejt palëve të treta. E drejta kundrejt palëve të treta bëhet efektive sapo Kompania e Sigurimit ka plotësuar detyrimin e tij të pagesës së dëmshpërblimit. Kur i Siguruari merr nga persona të tretë një pjesë të dëmshpërblimit për dëmin e pësuar Kompania e Sigurimit detyrohet t'i paguaj atij vetëm diferencën.

27.3 Mardhëniet ligjore në lidhje me kontratën e sigurimit

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga kontrata e sigurimit ndërmjet Kompanisë së Sigurimit dhe të Siguarave, zgjidhen nga gjykata kompetente e vendit ku lidhet kontrata e sigurimit ose siç do të bihet dakord në marrëveshje midis palëve. Në rastin kur i siguruari është person juridik ose fizik i huaj mosmarrëveshjet do të zgjidhen në përputhje me legjislacionin e vendit për të cilin bihet dakord ndërmjet palëve.

Shënim:— Është e nevojshme për të siguarin që kur të jetë në dijeni për një ngjarje e cila konsiderohet e mbuluar, sipas kësaj kontrate duhet të njoftojë menjëherë Siguruesin dhe e drejta për një mbulim të tillë varet nga përmbushja e këtij detyrimi.

28. Dispozita te fundit

28.1 Klauzola e përjashtimit të sulmeve kibernetike

Pavarësisht dispozitave të përmbajtjes së ndryshme brenda këtij sigurimi ose çdo miratimi pranohet që ky sigurim përjashton humbjen, dëmtimin real dhe personal të pasurisë, kostot ose shpenzimet e çfarëdo natyre, të shkaktuara direkt ose indirekt të shkaktuara nga çdo sulm kibernetik, qe rrjedhin nga perdorimi si mjet per te shkaktuar dem i cdo kompjuteri, sistemi kompjuterik, programi soft kompjuterash, kode keqdashesh, virusesh kompjuterike ose cdo sistemi apo paisje tjeter elektronike.

28.2 Klauzola e përjashtimit te semundjeve ngjitese

Pavarësisht parashikimeve në këtë Policë Sigurimi, Siguruesi nuk do të ofroje mbulim dhe Siguruesi nuk do te jetë i detyruar të paguajë ndonjë kërkesë për dëmshpërblim per cdo dem qe lidhet me deme trupore (perfshire Stresin Emocional ose traumen mendore ose fobine), cdo lloj demesh ose humbjesh materiale, te cilat jane ose pretendohet te jene shkaktuar nga, te ndikuara nga ose ne cdo menyre te lidhura me:

Sindromen e fituar te imunitetit te ulur (SIDA/AIDS) ose agjenteve patologjik te tij ose hepatiti;

Semundjet ngjitese: Me semundje ngjitese do te kuptohet cdo semundeje, e cila mund te transmetohet midis njerëzve, kafshëve ose bimëve, ose me anë të ndonjë substanca ose agjenti nga ndonjë organizëm në një organizëm tjetër, kur:

- substanca ose agjenti përfshin, por nuk kufizohet vetëm në një virus, bakter, parazit ose organizëm tjetër ose ndonjë ndryshim të tij, qoftë ai që konsiderohet i gjallë ose jo, dhe
- metoda e transmetimit, qoftë e drejtpërdrejtë apo e tërthortë, përfshin por nuk është e kufizuar në, transmetimin në ajër, transmetimin e lëngjeve trupore, transmetimin nga ose në ndonjë sipërfaqe ose objekt, të ngurtë, të lëngshëm ose gaz ose midis organizmave, dhe
- sëmundja, substanca ose agjenti mund të shkaktojë ose kërcënojë dëmtimin e shëndetit të njeriut ose të mirëqenies njerëzore ose mund të shkaktojë ose kërcënojë dëm, përkeqësim, humbje të vlerës së, tregtueshmërinë ose humbjen e përdorimit të pasurisë

28.3 Klauzola e Sanksioneve

Pavarësisht parashikimeve në këtë Policë Sigurimi, Siguruesi nuk do të jetë i detyruar të paguajë ndonjë kërkesë për dëmshpërblim ose të japë ndonjë përfitim sipas kësaj kontrate, nëse ofrimi i një mbulimi të tillë, pagesa e një kërkesë të tillë ose dhënia e një përfitimi të tillë do të ekspozonte Siguruesin ndaj ndonjë sanksioni, ndalimi ose kufizimi, sipas Rezolutës së Kombeve të Bashkuara ose sanksioneve tregtare ose ekonomike, ligjeve ose rregulloreve të Bashkimit European, gjithashtu sipas Ligjit Shqiptar, Mbretërisë së Bashkuar ose Shteteve të Bashkuara të Amerikës.